



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

**KOMUNA KLINE**

**ZYRA E PROKURIMIT**

01 NR. 35A-5107/18

DATE 27.07.2018

## KONTRATA NR.050/2018

Komuna Kline, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), **qe perfaqesohet** nga **Z.Abaz Foniqi –menaxher i z. Prokurimit** në një të anë; dhe **PROJECT PLUS sh.p.k.**, (në vazhdim "Kontraktuesi"), "me numer biznesi 70173032 dhe numer fiskal 600089248, **ME PERFAQESUES DREJTOR Z. AFRIM GASHI** ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

### RENOVIMI I OBJEKTIT TE SHKOLLES CARAVIK

me numër identifikues: 634-18-4301-521/634-18-057-521

**Neni 1 Lënda**

Lënda e kontratës është :

Ndërtim renovim rehabilitim sipas paramanave të dhëna në Ofertes  
Dhe cmimores së dhëna në tender.



**Neni 2 Çmimi**

2.1 Çmimi total i punëve është:

	PËRSHKRIMI I PUNEVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI NJËSI	ÇMIMI TOTAL PA TVSH
1	<b>PUNËT E DEMOLIMIT</b>				
1.1	Demolimi i dyerve perdhës dhe katin I , dorezimi dhe deponimi i tyre ne vend te cilin e aprovon punëdhënsi dhe organi mbikqyres.	copë	16.00	3.00	48.00
1.2	Demolimi i dritareve në përdhës dhe katin I dorzimi dhe deponimi i tyre ne vend te cilin e aprovon punëdhënsi dhe organi mbikqyres.	copë	27.00	4.00	108.00
1.3	Grryrja dhe largimi komplet shtresave të dyshemesë se perdheses dhe katit, përgaditja e baze deri tek shtresa rrafshuese - Estrihu, në llogari të hynë edhe bartja deri ne deponi ku e përcakton organi mbikqyrës.	m <sup>2</sup>	766.12	0.60	459.67
1.4	Demolimi i elementeve sanitare ne tualetet ekzistuese, dorezimi dhe deponimi i tyre ne vend te cilin e aprovon punëdhënsi dhe organi mbikqyres.	paushall	1.00	100.00	100.00
				<b>TOTALI</b>	<b>7.15.67</b>

2					
2.1	Grryrja - Largimi i shtresës së lyrjes ne salla ne përdhës dhe ne katin I si dhe hudhja ne deponi	m <sup>2</sup>	1080.00	0.15	162.00
2.2	Grryrja - Largimi i shtresës së lyrjes nëpër pllafonat e sallave ne perdhës dhe katin I	m <sup>2</sup>	668.00	0.15	100.20
2.3	Pastrimi (grryerja) fasades se jashteme nga mbeturinat , për vendosje dhe ngjitje te stiroporit te parapare .	m <sup>2</sup>	525.00	0.20	105.00
				<b>TOTALI</b>	<b>367.20</b>

3					
3.1	Furnizimi dhe Gletimi - suvatimi, lyrja e sallave dhe koridoreve ne perdhes dhe katin I. Baza ngjitëse, ngjitësi për rrjet Rabic, Gletimi me dy shtresa, ngjyrosja me polikollor ngjyr e bardh.	m <sup>2</sup>	1080.00	3.00	3.240.00
3.2	Furnizimi dhe suvatimi me llaç gëlqeror i mureve të toaleteve mbi pllakat e murit në dy shtresa si dhe lyrja me gëlqere.	m <sup>2</sup>	246.00	2.00	492.00
3.3	Furnizimi dhe vendosja e Stirodurit t=5 cm N4, ne sipërfaqjen e mureve të jashtme të objektit me të gjitha shtresat përcjellëse për Demit Fasad.	m <sup>2</sup>	599.40	7.00	4.195.80
				<b>TOTALI</b>	<b>7.927.80</b>

4					
4.1	Funizimi, transporti dhe montimi i dyrve te hyrjes nga PVC-ja, me dimensione 5.20x2.40 m	copë	1.00	450.00	450.00
4.2	Funizimi, transporti dhe montimi i dyrve te koridorit nga PVC-ja, me dimensione 2.20x2.65 m	copë	2.00	300.00	600.00
4.3	Funizimi, transporti dhe montimi i dyrve te sallave nga , me dimensione 0.9x2.10 m	copë	14.00	160.00	2.240.00
4.4	Furnizimi, transporti dhe montimi i dritareve nga PVC-ja, me dimensione 2.30x2.0 m	copë	25.00	165.00	4.125.00
4.5	Furnizimi, transporti dhe montimi i dritareve nga PVC-ja, me dimensione 2.30x1.75	copë	3.00	180.00	540.00

4.2	Furnizimi, transporti dhe montimi i dyrve ne tualete nga PVC-ja, me dimensione 0.9x2.10	copë	10.00	120.00	1.200.00
4.6	Furnizimi, transporti dhe montimi i dritareve nga PVC-ja, me dimensione 0.6x0.6	copë	6.00	80.00	480.00
4.7	Furnizimi, transporti dhe montimi i dritareve ne depo nga PVC-ja, me dimensione 1.2x1.4	copë	3.00	125.00	375.00
				<b>TOTALI</b>	<b>10.010.00</b>

<b>5</b>					
5.1	Furnizimi dhe vendosja e shtreses rrafshuese beton rrafshues, t= 7 cm , si dhe pergaditja e per vendosje te shtreses se Epoksidit ne hapsirat e shkolles. Epoksidi vendoset ne tere hapsiren e brendshme te objektit shkollor. Ngjyren e epoksidit vendos investitori-organi mbikqyres.	m <sup>2</sup>	650.00	5.70	3.705.00
5.2	Furnizimi, transporti dhe montimi i pllakave të keramikës për dysheme dhe mure per tualete 30x30 cm. Pllakat të jenë të kualitetit të lartë me ngjyrë sipas zgjedhjes së organit mbikqyrës. Në llogari hyjnë të gjitha elementet dhe materiali shtesë si ngjytësi , fugat etj deri në shtrimin e tyre. Pllakat të kenë ramje kah ujëmbledhesat të cilët duhet të sigurohen dhe montohen me të gjitha elementet deri në funksionim dhe të cilët hyjnë në këtë llogari.	m <sup>2</sup>	162.60	12.00	1.951.20
				<b>TOTALI</b>	<b>5.656.20</b>

6		PUNËT E MONTIMIT TE ELEMENTEVE NE TUALETE			
6.1	Furnizimi, transporti dhe montimi komplet i Lavamanve me shtylla porcelani me ngjyrë të bardh me dim. 60 x 50 cm të kualitetit të I - rë. Në çmim të llogaritit dhe sigurimi dhe montimi i sifonit të kromuar, baterija metalike e rezistushme për shkolla për ujë të ftoht komplet me "EK" Valvol, valvola me kolektor të ujit sanitar, pasqyra, demontimi i elementeve ekzistuese dhe kyaja në rjetin fekal dhe të ujësjellësit me të gjitha elementet deri në funksionimin e plotë të tyre. Llogaria bëhet komplet për pozicionin e përshkruar.	copë	4.0	150.00	600.00
6.2	Furnizimi, transporti dhe montimi i guacave te WC - se (e rrafshët - turke) prej porcelanit te klasit te I - rë, komplet me kazanin (fontanën) për ujë prej plastike, me gyp për shpërlarje Ø 5/4", dhe manzhele te gomes, dihtung te gomes dhe vida te mesingut me tipla, si dhe nje valvole ne kolektorin e ujit sanitar. Sigurimi dhe montimi i EK valvolës për lidhje të shpërlarësit si dhe një krua për pastrim. Llogaria komplet e pozicionit.	copë	6.0	130.00	780.00
6.3	Furnizimi, transporti dhe montimi i pisoarit, komplet me të gjitha elementet e nevojshme të klasit të I - rë. Në llogari hynë demontimi i pisoarve ekzistuese me kujdes dhe të gjitha punimet tjera deri në funksionimin e plotë të këtyre elementeve. Llogaria komplet e pozicionit.	copë	3.0	100.00	300.00
				<b>TOTALI</b>	<b>1.690.00</b>

7					
7.1	Gërmimi si dhe largimi i humusit në thellësi 30 cm me mekanizëm. Në çmim të llogaritit transporti i dheut të tepërt deri në vendin e caktuar nga investitori.	m <sup>3</sup>	22.7	3.00	68.10

7.2	Gërmimi si dhe largimi i dheut të themelit shiritore me mekanizëm. Në çmim të llogaritet transporti deri në vendin e caktuar nga investitori.	m <sup>3</sup>	9.1	3.00	27.30
7.3	Ngjeshja e shtresës së dheut me mekanizëm pas arritjes së kuotës së duhur të thellësisë së themeleve dhe nën pllakës.	m <sup>3</sup>	73.7	0.60	44.22
<b>TOTALI</b>					<b>139.62</b>

8 PUNËT E ZHAVORIT					
8.1	Furnizimi me material dhe shtrirja e zhavorit me trashësi 20 cm dhe ngjeshja e tij. Ø 0 - 31 mm nën themelet shiritore.	m <sup>3</sup>	6.1	8.50	51.85
8.2	Furnizimi me material dhe shtrirja e zhavorit për drenazhim rreth mureve perimetrike me gjerësi mesatarisht 50 cm.	m <sup>3</sup>	24.8	8.00	198.40
<b>TOTALI</b>					<b>250.25</b>

9 PUNËT E BETONIT					
9.1	Furnizimi dhe betonimi i themelit shiritore. Objekti shtesë tek nyjet sanitare me etazhitet P+0 themeli është me lartësi 40x60cm. Marka e betonit C 30-37.	m <sup>3</sup>	9.1	60.00	546.00
9.2	Furnizimi, bartja dhe betonimi i pllakës së përdhësës për objektin me dim. 20 cm. Marka e betonit C 30-37.	m <sup>3</sup>	14.7	60.00	882.00
9.3	Furnizimi me material dhe betonimi i shtyllave nga betoni i armuar me dimensione 25X25. Marka e betonit C 30-37	m <sup>3</sup>	1.6	60.00	96.00

9.4	Furnizimi, bartja dhe betonimi i trajeve nga betoni i armuar me markë C 30-37.	m <sup>3</sup>	2.2	65.00	143.00
9.5	Furnizimi, bartja dhe betonimi i pllakës së tavanit me dim. 20cm me markë C 30 - 37.	m <sup>3</sup>	14.7	62.00	911.40
<b>TOTALI</b>					<b>2.578.40</b>

10					
10.1	Armimi sipas statikës	kg	4230.0	0.65	2.749.50
<b>TOTALI</b>					<b>2.749.50</b>

11					
11.1	Furnizimi me material dhe hidroizolimi i dyshemesë dhe mureve , dhe WC-ve me ARDULAN 8+9 (2 herë).	m <sup>2</sup>	86.3	5.00	431.50
11.2	Furnizimi me material dhe hidroizolimi i pllakës së Kulmit me Sikaplan SGMA 15.	m <sup>2</sup>	73.6	7.00	515.20
<b>TOTALI</b>					<b>946.70</b>

12					
12.1	Furnizimi me material dhe muratimi i mureve me blloqe argjilore gjysëmgjater 19x25x19 cm. d = 25 cm, me llaq vazhdues	m <sup>3</sup>	82.0	4.00	328.00
12.2	Furnizimi me material dhe muratimi i mureve me blloqe argjilore gjysëmgjater 12x25x19 cm. d =12 cm, me llaq vazhdues	m <sup>3</sup>	68.5	2.00	137.00
<b>TOTALI</b>					<b>465.00</b>

13		PUNËT E NIVELIZIMIT			
13.1	Furnizimi me material dhe nivelizimi me ramje 0.5 %, i nyjeve sanitare me beton të varfër duke përfshirë edhe folinë, me trashësi min 6 cm.	m <sup>2</sup>	10.8	6.00	64.80
<b>TOTALI</b>					<b>64.80</b>

14		PUNËT E KULMIT			
14.1	Furnizimi, transporti si dhe punimi i kulmit nga materialet e nevojshme (shtyllat 12 x 12 cm, pahitë 10 x 12 cm, trarët e vekut 14 x 18 cm, trajet e pjerrta 10 x 14 cm, pajantat 10 x 12 cm, brinaket 10 x 12 cm, listela 3 x 5 cm, mbulesa nga llamperia e drurit 2,0 cm, folia aerodifuzive, tjegullat e tipit Tondach, kulmaret si dhe mbrojtëset e borës të vendosura në tjegulla në dy rende. Pozicioni të llogaritet komplet në projeksionin horizontal të kulmit me të gjitha shtresat sipas normave teknike.	m <sup>2</sup>	87.6	17.00	1.489.20
14.1	Furnizimi dhe montimi i olluqeve vertikale nga llamarina e plastifikuar, se bashku me konstruksionin mbajtës, me ngjyrë dhe trashësi 0.55 mm'. Gjerësia e ollukut është 12x12 cm'.	m <sup>2</sup>	5.6	10.00	56.00
<b>TOTALI</b>					<b>1.545.200</b>



15		KALDATORJA				
15.1	Kaldaja për ngrohje qendrore me ujë të ngrohët 90/70° me lëndë djegëse të ngurt t <sub>max</sub> =110°C, p <sub>max</sub> =3 bar me kapacitet Q=110 kW, EKO PKE 110, Enrad, Emtash ose prodhim i ngjashëm nga BE	copë		1.00	3.436.80	3.436.80
15.2	Pompa riqarkulluese GRUNDFOS ose të ngjashëm	X	X		X	X
15.2	UPS 40 - 120 /2F	copë		1.00	150.00	150.00
15.3	Ena e mbyllur e zgjerimit me membranë, V=150 litra, p <sub>max</sub> =10 bar	m <sup>2</sup>		1.00	150.00	150.00
15.4	Ventila me flanshe dhe kundër flanshe, diktung dhe bulona DN50	X	X		X	X
15.5	Ventila sferike DN 20	copë		3.00	5.00	15.00
15.5	DN 15	copë		2.00	5.00	10.00
15.6	Mbledhësi i papastertise DN 50	copë		2.00	5.00	10.00
15.7	Ventila jo kthyes me flanshe, kundër flanshe, bulona dhe diktung DN 50	X	X	1.00	50.00	50.00
15.8	Ventila siguruës me sustë, p=3 bar, DN 25	copë		1.00	5.00	5.00
15.9	Senzori i temperaturës së ujit për komandim të pompës qarkulluse të kaldajes	copë		2.00	2.00	10.00
15.11	Termomanometer	copë		1.00	25.00	25.00
15.11	Gypa te zi nga celiku DN 15	copë	X	6.00	45.00	270.00
15.11		m		12.00	5.00	60.00

15.12	Fitingu për gyp të çelikut është 50 % nga poz. A.11	%			
15.13	Ventil mbushje zbrazje DN 20		0.50	500	250.00
15.14	Kuadri elektrik për furnizim e rrymë për elementet e kaldatorës	copë	2.00	25.00	50.00
15.15	Pastrimi dhe ngjyrosja	komplet	1.00	150.00	150.00
15.16	Izolimi termik i gypave në kaldatore dhe qynkës me lesh mineral 50 mm me mbështjellje të lamarinës së Al- 0.5 mm	m2	12.00	2.00	24.00
15.17	Aparat kundër zjarrit S-9	m2	12.00	4.00	48.00
15.18	Punimi i qynkës Ø 250 mm, nga llamarina e çelikut 2.5mm l= 1000 mm për kyqje në oxhak	m2	1.00	50.00	50.00
15.19	Ventilatori me V= 1100 m3/h	copë	1.00	50.00	50.00
15.2	Trasporti	komplet	1.00	150.00	150.00
15.21	Shqyrtimi i instalimit	komplet	1.00	50.00	50.00
				80.00	80.00
<b>TOTALI</b>					<b>5.103.80</b>

16		TRUPAT NGROHËS DHE TUBACIONI			
16.1	Radiatorë panel të çelikut 22 - 600 te fabrikes ENRAD - Gjilan ose te ngjashem	x	x	x	X
	22-600/1000	copë	1	100.00	100.00
	22-600/1400	copë	1	100.00	100.00
	22-600/1600	copë	25	100.00	2.500.00
	22-600/2000	copë	5	100.00	500.00
	G-500/1500	copë	2	100.00	200.00
	16.2	Ventila ne hyrje te radiatorit R 15 - termokoke	copë	4	80.00
16.3	Ventila në dalje të radiatorit R15	copë	38	4.00	152.00
16.4	Gypa te zi nga celiku	x	x	4.00	152.00
				x	X

	DN 15	m	112	1.00	112.00
	DN 20	m	96	1.00	96.00
	DN 25	m	90	1.00	90.00
	DN 32	m	84	1.00	84.00
	DN 40	m	78	1.00	78.00
	DN 50	m	54	1.00	54.00
16.5	Fitingu për gyp është 50 % nga poz.B4	%	50%	400	200.00
16.6	Pastrimi dhe ngjyrosja	komplet	1	20.00	20.00
16.7	Kalimi gyp ne gyp dhe izolimi termik i gypave të çelikut me plamaflex 9 mm në vendet ku kalohet në mure dhe nivelizim	komplet	1	50.00	50.00
16.8	Ventil automatik i ajrosjes R15	copë	8	50.00	400.00
16.9	Depërtimet e vrimave për kalimin e rrjetit dhe hapja e vendeve për vendosjen e kutiave metalike	komplet	1	20.00	20.00
16.1	Trasporti	komplet	1	50.00	50.00
16.1	Shqyrtimi i instalimit	komplet	1	50.00	50.00
<b>TOTALI</b>					<b>5.328.00 €</b>

### **REKAPITULLIM:**

POZICIONI	PERSHKRIMI	VLERA
1	PUNET EDEMOLIMIT	715.67
2	LARGIMI I SHTRESAVE TE MATERJALIT TE VJETER NE OBJEKT	367.20
3	PUNET E SUVATIMIT DHE FASADIMIT	7.927.80
4	PUNET E ZDRUKTHARISE	10.010.00
5	PUNET E DYSHEMESE	5.656.20
6	PUNET E MONTIMIT DHE TE ELEMENTEVE TE TUALETIT	1.680.00
7	PUNET E DHEUT	139.62
8	PUNET E ZHAVORIT	250.25
9	PUNET E BETONIT	2.578.40

10	PUNET E ARMATURES	2.749.50
11	PUNET E HIDROIZOLIMIT	946.70
12	PUNET E MURATIMIT	465.00
13	PUNET E NIVELIZIMIT	64.80
14	PUNET E KULMIT	1.545.20
15	KALDATORJA	5.103.80
16	TRUPAT E NGROHJES DHE TUBACIONI	5.328.00

**VLERA TOATLE PA TVSH.....45.528.14 €**

**Tvsh 18 % .....8.195.07 €**

**VLERA TOTALE ME TVSH .....53.723.21 €**

**53.723.21 € ( Pesedhjetetremijeshategindenjezetetreeuroe21/100 euros )**

2.2. Plani per implemmentim programi do te jete 30 dite kalendarik

2.3. Siguria e ekzekutimit do te depozitohen ne vlere 5.372.32 € me validitet 30+30= 60 dite kalendarik .

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.-sipas situacioneve dhe perfundimit te PUNEVE sipas planit dinamik prej 30 dite kalendarik , me raport nga menaxheri i projektit, raport pranimi dhe raportin detal te menaxhmit te kontrates - pas perfundimit te Punimeve .

- Situacioni i pare ne vler 20.000.00 €

-Situacioni i dyte ne vlere 20.000.00 €

-Situacioni i trete ne vlere 8.341.89 € ( pas pranimit te perkoheshem teknik )

-Situacioni i katert –perfundimtare ne vlere 5.371.32 € (Ruajtja e paras per afatin e garancionit te punimeve ne afat 12 muaj apo me Siguracion )

### **Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

(a) Marrëveshja e kontratës;

(b) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);  
 3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

#### Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në kater origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

4.5. Per menaxhim te kontrates bazuar ne nenin 81 te LPP 04/L-42 emerohet me vendim te ZKA -nga Njesia kerkuese , Drejtoria Komunale e Arsimit ,

Për Autoritetin Kontraktues  
 Komuna Kline

Për Kontraktuesin

PROJECT PLUS SHPK –PRISHTINE

Emri:	Abaz Foniqi	AFRIM GASHI
Pozita:	Zyrtar përgjegjës prokurimit	Drejtor
Nënshkrimi:		
Data:	27.07.2018	27.07.2018
Vula:		

## PJESA II E KONTRATËS KUSHTET E PËRGJITHSHME

### Neni 1

#### Përkufizimet

- 1.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.
- 1.2 “Shërbimet” do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.
- 1.3 “Ofrues i shërbimeve” është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.
- 1.4 “Personeli” do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.
- 1.5 “Çmimi i kontratës” do të thotë shumën e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.
- 1.6 “Nënkontraktuesi” do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.
- 1.7 “Palë” nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe “Palët” nënkupton të dy prej tyre.
- 1.8 “Autoriteti Kontraktues” nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.
- 1.9 “KPK” nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.
- 1.10 “KVK” nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

### Neni 2

#### Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

- 2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.
- 2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

### Neni 3

#### Transferimi

- 3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.
- 3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:
- a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
  - b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve sigurve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguresit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.
- 3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.
- 3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

### Neni 4 Nën-kontraktimi

- 4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.
- 4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertes. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktin pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përbushin kërkesat e përshtatshme.
- 4.3 Autoriteti kontraktues nuk njihë lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

#### **Neni 5 Tatimi**

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit të shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofruesi i Shërbimeve.

#### **Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve**

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrimit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundojë aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktiviteteve.

#### **Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit**

7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përmbushur detyrimet e tij sipas kontratës;
- b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftojë Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejojë Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informojë Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

#### **Neni 8 Forca Madhore**

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktohet nga një forcë madhore që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marrë të gjitha masat e arsyeshme për të mënjeluar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

#### **Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues**

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitohet ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- (g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- (i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;
- (j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

## Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

## Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.



11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofruesi i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të botojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tilla do të jenë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identifikuar në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkesë me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i pacifikshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuar.

#### **Neni 12** **Obigimet e Autoritetit Kontraktues**

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet t'i kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "Menaxherin e Projektit", i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

#### **Neni 13** **Dëmet e Likuiduara**

13.1 Nëse Ofruesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zbrisë dëmet e likuiduara nga pagesat të cilat duhet t'i behen Ofruesit të Shërbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbimë parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Shërbimeve të:

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem në emër të vete Autoritetit, me një operatore ekonomik:*

- konfiskojë garancinë e performancës;
- të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënie të pjesës së mbetur të shërbimeve. Ofruesi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem në emër të vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:*

- të konfiskojë garancinë e realizimit;
- të ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- të ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike korvizë.

c. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar në emër të disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me një operatore ekonomik:*

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bërë porosinë anulon porosinë dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% të porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:*

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% të porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;

- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofruesi i shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe

- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

#### **Neni 14 Siguria e Ekzekutimit**

14.1 Ofruesi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosëkzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

14.3 Garancioni i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

#### **Neni 15 Sigurimi që do të merret nga Ofruesi i Shërbimit**

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

#### **Neni 16 Parimet të përgjithshme të pagesave**

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendrike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përmbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Neni 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

#### **Neni 17 Kualiteti i Kontrollit**

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesin e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç është definuar në KVK.

## Neni 18

### Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues.

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

## Neni 19

### Konsekuencat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur në Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

## Neni 20

### Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjeke për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

## Neni 21

### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

## Neni 22 Dëmshpërblimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do të mbroje dhe do të dëmshpërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do të jete përgjegjës për të gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë por jo kufizuar shpenzimet e tarifës së avokateve dhe shpenzimet në lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit të Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti të siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj palë të tretë

### 1. PJESA III E KONTRATËS kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

*[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]*

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Kline.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë SHQIPE
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është : <b>DREJTORIA KOMUNA E ARSIMIT , ME VENDIM NGA ZKA</b>
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është <b>10 % NGA VLERA E KONTRATES PER PERIUDHEN 30+30=60 DITE</b> <b>Perkatesisht vlere 5.372.32 €.</b>
	14.2	Per cdo dite vonese nga Plani dinamik O.E qe nuk ka arsyeshmeri nga Menaxheri i Kontrate do te penalizohet ne vlere 0.025 % e Vleres se kontrates per dite vonese .
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	15.1	Rreziqet dhe mbulesat nga sigurimi do të jenë: a) Mjetet motorike të Palës së Tretë <b>100 % pergjegjesi nga Pune kryesi</b> b) Përgjegjësia e pales së tretë <b>100 % pergjegjesi nga pune kryesi</b> c) Përgjegjësia e punëdhënësit dhe kompensimi i punonjësve Pergjegjesi e punekryesit <b>100 % pergjegjesi nga pune kryesi. Sipas Ligjit mbi Sigurimin e punetoreve dhe Ligjit mbi sigur ne Pune.</b> d) Përgjegjësia profesionale e O.E. <b>100 % pergjegjesi nga pune kryesi</b> e) Humbje ose dëmtim të pronës dhe pergjegjesi e o.e.
Kualiteti i Kontrollit	17.1	Punet –Sherbimet duhet te jene ne cilesi dhe saktesi simbas specifikacionit te produkteve te perdorura dhe cilesis se punimeve conform ofertes . Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga Autoriteti Kontraktues janë si më poshtë: <b>aty per aty</b> Periudha e përgjegjësise së Defekteve është gjate tere afatit te Implementimit te projektit:

		<i>Periudha Garantuese eshte 12 muaj pas pranimit te puneve</i>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	<i>Specifikoni departamentin e Komisionit përgjegjës për pajtim]</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	<p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <i>[specifikoni gjykatën kompetente]</i> në pajtim me ligjin në Kosovë.</p> <p>ose</p> <p>b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të në pajtim me <i>specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)]</i>.</p>



## PLANI PËR MENAXHIMIN E KONTRATËS

Sipas Nenit 81.2 të Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042

Data e përgatitjes së PMK<sup>1</sup>: 27.07.2018

Përgatitur nga: **vendos emrin dhe mbiemrin e Menaxherit të Projektit të AK-  
-DREJTOR I DREJTORISE KOMUNALE E ARSIMIT -IMPLEMENTUESE E PROJEKTIT**

Numri i Prokurimit	634-18-4301-521/634-18-57-521		
Titulli i Kontratës	RENOVIMI I OBJKTIT TE SHKOLLES CARAVIK		
Punë/Shërbime/Furnizime	Viti Buxhetor	Emri dhe mbiemri i Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit	
PUNE - EKZEKUTIM	2018	BAZ-FONICI	

Ngjarjet/Rezultatet e Kontratës	DETAJET E IMPLEMENTIMIT Afatet 30 DITE PUNE KALENDARIK VLERA 53.723.21€
<b>Pjesët nën 'Detajet e Implementimit' në <i>italike</i> duhet të kompletohen dhe të bien dakord në mesë të palëve të kontratës para inicimit të implementimit të kontratës. PMK duhet të përtërihet gjatë implementimit të kontratës. Vendos Nuk Aplikohet për ato që nuk janë relevante</b>	
<b>I. Fillimi/ Mobilizimi i Kontratës</b>	
Njoftimi për fillimin e punës/shërbimeve/furnizimit të mallrave	27.07.2018
Afati i përmbushjes	30 DITE
Pranimi i garancisë së performancës dhe lirimi i sigurimit të tenderit	VLER 5.272.32 € ME VALIDITET 60 DITE
Pranimi i garancisë së pagesës në avans,	SKA AVANS

<sup>1</sup> Plan i Menaxhimit të Kontratës është dokument i gjallë i cili do të përtërihet bazuar në mbikëqyrjen e punëve, shërbimeve apo mallrave në pajtim me kushtet e parashtruara në kontratën origjinale. Plan i Menaxhimit të Kontratës është i hapur për monitorim të KRPP-së gjatë implementimit të kontratës dhe të gjitha auditimeve tjera të kryera nga organet shtetërore. PMK duhet të përdoret së bashku me rregullat e miratuara për menaxhimin e aktiviteteve të kontratës, të nxjerra nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.

**Finalizimi i Planit të Menaxhimit të Kontratës<sup>2</sup>:**

**Në emër të Autoritetit Kontraktues ; KK KLINE – DREJTORIA E ARSIMIT – KLINE**

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

Emri: ARBEN LIMANAJ

Pozita: *Menaxheri i Projektit*

Data: \_\_\_\_\_

**Në emër të [Kontraktuesit/Ofruesit të Shërbimeve -PROJECT PLUS SHPK - PRISHTINE**

Emri: AFRIM GASHI

Nënshkrimi:

\_\_\_\_\_

Pozita:

\_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_\_

*Menaxheri i Projektit*  
*AFERDITA MORINA*

\_\_\_\_\_

<sup>2</sup> Të nënshkruhet nga dy Menaxherët e Projektit



# ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company I.S.C.

*Gjithcka që duhet ta keni*

## Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Polices me Nr. 68703

Për Komuna Klinë

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të "Project Plus" Sh.P.K.

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: "RENOVIMI I OBJEKTIT TE SHKOLLES CARAVIK"

Nr. prokurimit: 634-18-4301-521, Nr. brendshëm: 634-18-057-521

### Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **5,372.32€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **5,372.32€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë deri më 25.09.2018 ora 08:48:59

Data lëshimit: 27.07.2018

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit



0027104